



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 183

Tiranë – E hënë, 16 tetor 2017

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 56, datë 3.10.2017	Për miratimin e rregullores “Për fondin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe procedurat për administrimin e tij”	9159
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 57, datë 3.10.2017	Për dhënien e miratimit paraprak për kryerjen e veprimtarisë financiare shtesë nga Banka Intesa Sanpaolo Albania sh.a.....	9164
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 58, datë 3.10.2017	Për disa ndryshime në rregulloren “Mbi raportimet në Bankën e Shqipërisë sipas sistemit raportues të unifikuar”.....	9165



VENDIM
Nr. 56, datë 3.10.2017

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR FONDIN E NDËRHYRJES SË
JASHTËZAKONSHME DHE
PROCEDURAT PËR ADMINISTRIMIN
E TIJ”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a”, dhe të nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; dhe të nenit 6, pika 6, nenit 71, nenit 73, pika 1 dhe 6, nenit 75, pika 1 dhe 2, nenit 76, pika 2, neni 77, pika 6, nenit 79, si dhe nenit 87 të ligjit nr. 133, datë 22.12.2016, “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; me propozim të Departamentit për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren “Për fondin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe procedurat për administrimin e tij”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Departamenti për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme dhe Agjencia e Sigurimit të Depozitave me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Gent Sejko

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është të përcaktojë:

- a) krijimin e “Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme”;
- b) metodologjinë për llogaritjen e nivelit të “Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme”;

c) metodologjinë për përcaktimin e kontributit vjetor të çdo banke, si dhe procedurën mbi pagesën e këtij kontributi;

d) kontributet e jashtëzakonshme, si dhe rrethanat dhe kushtet për pezullimin pjesërisht ose tërësisht të pagesës së këtyre kontributeve;

e) procedurën për miratimin e politikës së investimit të “Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme”;

f) procedurën për miratimin e masës dhe mënyrës së pagesës vjetore për rimbursimin e kostove në lidhje me administrimin e “Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme”;

g) procedurën për konsultimin e kritereve të përzgjedhjes të audituesit të jashtëm të pasqyrave financiare vjetore të “Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme”;

h) raportimin dhe shkëmbimin e informacionit midis Bankës së Shqipërisë dhe Agjencisë së Sigurimit të Depozitave në lidhje me “Fondin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme”.

Neni 2
Baza juridike

Kjo rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të:

a) nenit 12, shkronja “a”, dhe nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

b) nenit 6, pika 6, nenit 71, nenit 73, pika 1 dhe 6, nenit 75, pika 1 dhe 2, nenit 76, pika 2, dhe 77, pika 6, nenit 79, si dhe nenit 87 të ligjit nr. 133, datë 22.12.2016, “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë” (më poshtë ligji “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme”);

c) ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Neni 3
Subjektet

Subjekte të kësaj rregulloreje janë bankat dhe degët e bankave të huaja të licencuara për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë dhe Agjencia e Sigurimit të Depozitave.



Neni 4 Përkufizimet

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar në ligjin “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme”, si dhe në ligjin “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, për qëllim të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) “Administratori përkatës” është administratori i Bankës së Shqipërisë, i cili ka në varësi Departamentin për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme, sipas përcaktimit në strukturën organizative të Bankës së Shqipërisë.

b) Niveli i synuar i “Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme” është niveli i fondit që llogaritet çdo vit nga Banka e Shqipërisë mbështetur në të dhënat më të fundit të audituara të bankave, sipas pikës 1 të nenit 75, të ligjit “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme”.

c) Niveli vjetor i “Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme” është shuma e fondit që llogaritet për t’u paguar çdo vit nga të gjitha bankat për plotësimin e nivelit të synuar sipas shkronjës “b” të kësaj pike.

d) Kontributi vjetor është shuma vjetore që paguan çdo bankë dhe që shërben për të plotësuar nivelin vjetor të “Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme” sipas shkronjës “c” të kësaj pike.

KREU II FONDI I NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME

Neni 5 Krijimi i “Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme”

1. “Fondi i ndërhyrjes së jashtëzakonshme” krijohet nga pjesa e kontributit që paguajnë bankat deri në datën 10 janar 2018, në llogarinë e ASD-së, pranë Bankës së Shqipërisë, sipas nenit 20 të kësaj rregulloreje.

2. ASD-ja hap pranë Bankës së Shqipërisë llogarinë “Fondi i ndërhyrjes së jashtëzakonshme”, jo më vonë se një muaj nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje.

3. Burimet financiare të “Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme” janë ato të përcaktuara në nenin 72 të ligjit “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme”.

4. “Fondi i ndërhyrjes së jashtëzakonshme” përdoret vetëm për rastet e parashikuara në nenin 74 të ligjit “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme”.

Neni 6 Niveli i synuar i “Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme”

1. “Fondi i ndërhyrjes së jashtëzakonshme” duhet të arrijë nivelin 0.5% të detyrimeve totale të të gjitha bankave, të llogaritura si diferencë midis aktiveve totale të të gjitha bankave dhe kapitalit rregullator të tyre, deri në datën 11 korrik 2027.

2. Banka e Shqipërisë përllëgarit çdo vit nivelin e synuar të “Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme” në bazë të të dhënave të bilancit të audituar të të gjitha bankave, me qëllim plotësimin e nivelit të “Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme”, sipas pikës 1 të këtij neni.

3. Përllëgaritja e nivelit të synuar të “Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme” bëhet sipas formulës së mëposhtme:

$NSF_n = 0.5\% * (\text{Totali i aktiveve}_{n-2} - \text{kapitali rregullator}_{n-2})$

ku:

- n – merr vlera nga viti 2018 deri në vitin 2027. Në rast të zgjatjes së afatit të plotësimit të fondit nga Banka e Shqipërisë sipas pikës 2, të nenit 75, të ligjit “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme”, vlerat e n -së shtyhen në përputhje me këtë afat.

- NSF_n – niveli i synuar i “Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme” për vitin n .

- 0,5% – koeficient sipas përcaktimeve në ligjin “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme”.

- **Totali i aktiveve** $_{n-2}$ – aktivet totale të të gjitha bankave në fund të vitit $n-2$, sipas raportimit të pasqyrave financiare të audituara në Bankën e Shqipërisë në bazë të nenit 52, të ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.

- **Kapitali rregullator** $_{n-2}$ – shuma e kapitalit rregullator të të gjitha bankave, në fund të vitit $n-2$, sipas raportimit të pasqyrave financiare të audituara në Bankën e Shqipërisë në bazë të nenit 52, të ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.



Neni 7

Niveli vjetor i “Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme”

1. Për plotësimin e nivelit të synuar të “Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme”, sipas pikës 2 të nenit 6 të kësaj rregulloreje, Banka e Shqipërisë përllorarit çdo vit nivelin vjetor të “Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme” sipas formulës së mëposhtme:

$$NVFNJ_n = \frac{NSF_n - \text{Gjendja e fondit}_{n-1}}{2027-n+1}$$

ku:

- $NVFNJ_n$ – niveli vjetor i “Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme” për vitin n .

- **Gjendja e fondit** $_{n-1}$ – gjendja e “Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme” në fund të vitit $n-1$, sipas raportimit të ASD-së.

2. Në rast të zgjatjes së afatit të plotësimit të fondit nga Banka e Shqipërisë sipas pikës 2 të nenit 75, të ligjit “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme”, viti 2027 në formulën e pikës 1 të këtij neni shtyhet në përputhje me këtë afat.

3. Pas auditimit të pasqyrave financiare të gjendjes së fondit nga audituesi i jashtëm, Banka e Shqipërisë, në rast nevoje, bën korrigjimet përkatëse në përlloraritjen e nivelit vjetor të “Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme” të vitit pasardhës.

KREU III

KONTRIBUTI VJETOR

Neni 8

Përlloraritja e kontributit vjetor

1. Për plotësimin e nivelit vjetor të “Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme”, të përcaktuar në nenin 7 të kësaj rregulloreje, bankat paguajnë kontributin vjetor, i cili përlloraritet sipas formulës së mëposhtme:

$$KVF_n = NVFNJ_n \times \text{Pesha e bankës}_n$$

ku:

- KVF_n - kontributi vjetor i secilës bankë për vitin n .

- $NVFNJ_n$ – niveli vjetor i “Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme” për vitin n , i përlloraritur sipas nenit 7 të kësaj rregulloreje.

- **Pesha e bankës** n - pesha e detyrimeve të bankës për vitin n , e llogaritur sipas pikës 2 të këtij neni.

2. Pesha e detyrimeve të bankës përlloraritet sipas formulës së mëposhtme:

$$\text{Pesha e bankës}_n = \frac{\text{Aktivet e bankës}_{n-2} - \text{Kapitali rregullator i bankës}_{n-2}}{(\text{Totali i aktiveve}_{n-2} - \text{Kapitali rregullator}_{n-2})} * 100\%$$

ku:

- **Aktivet e bankës** $_{n-2}$ – aktivet e secilës bankë, në fund të vitit $n-2$, sipas raportimit të pasqyrave financiare të audituara në Bankën e Shqipërisë në bazë të nenit 52, të ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.

- **Kapitali rregullator i bankës** $_{n-2}$ – kapitali rregullator i secilës bankë, në fund të vitit $n-2$, sipas raportimit të pasqyrave financiare të audituara në Bankën e Shqipërisë në bazë të nenit 52, të ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 9

Bankat e licencuara gjatë vitit ushtrimor

1. Një bankë e licencuar gjatë vitit ushtrimor, e cila ushtron veprimtari bankare vetëm për një pjesë të periudhës së llogaritjes së kontributit, paguan kontribut vjetor të pjesshëm në përpjesëtim me periudhën që ka ushtruar veprimtarinë bankare.

2. Kontributi vjetor i pjesshëm përlloraritet duke shumëzuar kontributin vjetor me 1/12 për çdo muaj të plotë të periudhës që banka ka ushtruar veprimtari bankare.

Neni 10

Njoftimi dhe pagesa e kontributit vjetor

1. Administratori përkatës përcakton me urdhër të veçantë masën e kontributit vjetor për çdo bankë, si dhe afatin e përcaktuar për pagimin e tij.

2. Urdhri për pagimin e kontributit vjetor sipas pikës 1 të këtij neni i njoftohet ASD-së dhe çdo banke dhe përmban:

a) nivelin e synuar të “Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme”;

b) nivelin vjetor të “Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme”;

c) gjendjen e fondit dhe korrigjimin përkatës sipas pikës 3, të nenit 7 të kësaj rregulloreje;

d) kontributin vjetor të bankës;

e) numrin e llogarisë së ASD-së pranë Bankës së Shqipërisë, sipas pikës 2 të nenit 5 të kësaj rregulloreje, në të cilën kryhet pagesa e kontributit;

f) afatin e pagimit të kontributit vjetor.



2. Urdhri bëhet me shkresë zyrtare me postë të regjistruar brenda muajit shkurt të çdo viti kalendarik.

3. Bankat paguajnë kontributin vjetor në lekë, në një shumë të vetme deri në datën 30 prill të çdo viti, në llogarinë e përkryer sipas shkronjës “e”, të pikës 2 të këtij neni.

4. Në rastin e një banke të licencuar gjatë vitit ushtrimor, kontributi i pjesshëm vjetor paguhet së bashku me kontributin vjetor të periudhës pasardhëse.

5. ASD-ja u konfirmon bankave dhe Bankës së Shqipërisë marrjen e pagesës së kontributit vjetor, brenda 15 ditëve nga kryerja e pagesës.

6. Në rast se banka nuk paguan kontributin vjetor në afatin e caktuar sipas pikës 1 të këtij neni, Banka e Shqipërisë me të marrë dijeni, njofton bankën dhe ASD-në për detyrimin për pagimin e kamatëvonesave sipas pikës 2 të nenit 81, të ligjit “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme”, përmes një urdhri të veçantë të administratorit përkatës. ASD-ja përlllogarit kamatëvonesat në momentin e kryerjes së pagesës së kontributit nga banka.

KREU IV

KONTRIBUTET E JASHTËZAKONSHME

Neni 11

Kontributet e jashtëzakonshme

1. Bankat paguajnë kontribute të jashtëzakonshme në rastet e përcaktuara në pikën 1 të nenit 77, të ligjit “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme”. Vendimi për pagimin e kontributeve të jashtëzakonshme merret nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë dhe përfshin masën e kontributit të jashtëzakonshëm për çdo bankë dhe afatin e përcaktuar për pagimin e tij.

2. Vendimi për pagimin e kontributit të jashtëzakonshëm sipas pikës 1 të këtij neni i njoftohet ASD-së dhe çdo banke.

3. Në rast se banka nuk paguan kontributin e jashtëzakonshëm deri në afatin e përcaktuar sipas pikës 1 të këtij neni, ASD-ja njofton Bankën e Shqipërisë, brenda 15 ditëve nga mbarimi i afatit.

Neni 12

Pezullimi i pagesës së kontributit të jashtëzakonshëm

1. Banka e Shqipërisë, me kërkesë të bankës, mund të pezullojë tërësisht ose pjesërisht pagesën e kontributit të jashtëzakonshëm të bankës në përputhje me pikën 5 të nenit 77, të ligjit “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme”, nëse është e nevojshme për të mbrojtur pozicionin financiar të saj.

2. Kërkesa sipas pikës 1 të këtij neni duhet të paraqitet pranë Bankës së Shqipërisë, jo më vonë se 10 ditë pune nga marrja e urdhrimit për pagesën e kontributit të jashtëzakonshëm, dhe shoqërohet me informacionin e nevojshëm për të kryer vlerësimin e ndikimit të pagesës së këtij kontributi në pozicionin financiar të bankës. Banka e Shqipërisë mund të kërkojë çdo informacion shtesë të nevojshëm për të kryer vlerësimin e mësipërm.

3. Gjatë shqyrtimit të kërkesës së bankës, për të përcaktuar nëse ajo plotëson kushtet për pezullim sipas pikës 4 të këtij neni, Banka e Shqipërisë vlerëson ndikimin që mund të ketë pagesa e kontributit të jashtëzakonshëm mbi aftësinë paguese dhe treguesit e likuiditetit të bankës, brenda 10 ditëve pune.

4. Banka e Shqipërisë (Këshilli Mbikëqyrës) pezullon tërësisht ose pjesërisht pagesën e kontributeve të jashtëzakonshme të bankës kur vlerëson se pagesa do të çonte në krijimin e njërit prej kushteve të mëposhtme:

a) niveli i raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit të bankës bie nën nivelin minimal të lejuar brenda gjashtëmujorit të ardhshëm;

b) treguesit e likuiditetit bien nën nivelin minimal të lejuar brenda gjashtëmujorit të ardhshëm.

5. Banka e Shqipërisë kufizon periudhën e pezullimit deri në masën që është e nevojshme për të shmangur rreziqet ndaj pozitës financiare të bankës dhe monitoron rregullisht nëse kushtet për pezullim të parashikuara në pikën 4 të këtij neni vazhdojnë të ekzistojnë.

6. Banka e Shqipërisë mund të zgjasë afatin e pezullimit vetëm një herë, në rast se vazhdojnë të ekzistojnë kushtet për pezullimin të përcaktuar në pikën 4 të këtij neni. Kjo zgjatje e afatit nuk duhet të kalojë 6 muaj.



7. Vendimi për pezullimin e kontributit të jashtëzakonshëm i njoftohet edhe ASD-së së bashku me njoftimin për bankën.

Neni 13

Vlerësimi i ndikimit të pagesës së kontributit të jashtëzakonshëm në aftësinë paguese

1. Banka e Shqipërisë vlerëson ndikimin e pagesës së kontributit të jashtëzakonshëm në pozicionin e kapitalit rregullator të bankës, sipas pikës 3 të nenit 12, të kësaj rregulloreje. Ky vlerësim duhet të përfshijë analizën e ndikimit që mund të ketë pagesa e kontributit të jashtëzakonshëm në raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit.

2. Për qëllim të këtij vlerësimi, vlera e kontributit të jashtëzakonshëm zbritet nga vlera e kapitalit rregullator të bankës.

Neni 14

Vlerësimi i ndikimit të pagesës së kontributit të jashtëzakonshëm në treguesit e likuiditetit

1. Banka e Shqipërisë vlerëson ndikimin e pagesës së kontributit të jashtëzakonshëm në treguesit e likuiditetit të bankës, sipas pikës 3 të nenit 12, të kësaj rregulloreje. Ky vlerësim duhet të përfshijë analizën e ndikimit që mund të ketë pagesa e kontributit të jashtëzakonshëm në treguesit e likuiditetit në monedhën kombëtare (lek) dhe në total.

2. Banka e Shqipërisë vlerëson respektimin e nivelit të lejuar të treguesve të likuiditetit në momentin e pagesës së kontributit të jashtëzakonshëm, duke konsideruar fluksin dalës (sipas përcaktimit në rregulloren “Për administrimin e rrezikut të likuiditetit”) të barabartë me 100% të vlerës së kontributit të jashtëzakonshëm.

KREU V

PROCEDURAT PËR ADMINISTRIMIN E MJETEVE FINANCIARE TË FONDIT

Neni 15

Politika e investimit të mjeteve financiare të “Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme”

1. “Fondi i ndërhyrjes së jashtëzakonshme” administrohet nga ASD-ja në përputhje me politikën e investimit të mjeteve financiare të fondit.

2. Politika e investimit të mjeteve financiare të fondit miratohet nga administratori përkatës me propozim të ASD-së dhe orientohet nga parimet e investimit për ruajtjen e një profili rreziku të ulët dhe likuiditeti të lartë të mjeteve financiare të fondit, me qëllim disponueshmërinë e menjëhershme të fondit në rast nevoje.

3. ASD-ja paraqet për miratim çdo vit pranë Bankës së Shqipërisë politikën e investimit të fondit. Propozimi sipas kësaj pike shoqërohet me relacionin shpjegues për projektin e paraqitur.

4. Banka e Shqipërisë miraton politikën e investimit të fondit, që përfshin kriteret dhe kufijtë e përqendrimit dhe maturitetit në investim të mjeteve financiare të fondit dhe çdo ndryshim të tyre, sipas propozimit të ASD-së, jo më vonë se një muaj nga paraqitja e propozimit.

5. ASD-ja administron “Fondin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme” në pavarësi të plotë nga fondet e tjera. Për këtë qëllim, ASD-ja mban llogari dhe regjistra financiarë të veçantë për fondin, si dhe mundëson raportime të veçanta në lidhje me administrimin e tij.

Neni 16

Pagesa vjetore për administrimin e “Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme”

1. Agjencia e Sigurimit të Depozitave merr një pagesë vjetore për rimbursimin e kostove për administrimin e mjeteve financiare të “Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme”.

2. Brenda tremujorit të parë të çdo viti, ASD-ja paraqet pranë Bankës së Shqipërisë pasqyrat financiare të “Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme” të vitit paraardhës dhe një relacion të detajuar mbi shpenzimet vjetore të kryera për administrimin e fondit. Shpenzimet vjetore të fondit përfshijnë vlerën e kostove të drejtpërdrejta dhe të tërthorta të administrimit të fondit. Kostot e drejtpërdrejta janë shpenzimet në formën e komisioneve bankare dhe të ngjashme me to, që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë vetëm me administrimin e fondit. Kostot e tërthorta janë kostot e personelit të ASD-së të përfshirë në procesin e administrimit të fondit, të llogaritura në mënyrë proporcionale sipas numrit të transaksioneve të kryera për investimin e mjeteve të fondit.

3. Jo më vonë se një muaj nga paraqitja e relacionit sipas pikës 2 të këtij neni, administratori



përkatës vendos për masën e rimbursimit të kostove që duhet të marrë ASD-ja në lidhje me administrimin e fondit.

4. ASD-ja mban pagesën vjetore nga llogaria e “Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme” pranë Bankës së Shqipërisë, pas miratimit nga Banka e Shqipërisë, sipas pikës 3 të këtij neni.

Neni 17

Audituesi i jashtëm i pasqyrave financiare të “Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme”

1. Pasqyrat financiare vjetore të “Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme” auditohen nga auditues të jashtëm të specializuar, që miratohen nga Këshilli Drejtues i ASD-së.

2. Kriteret për përzgjedhjen e audituesit të jashtëm i dërgohen për mendim paraprakisht Bankës së Shqipërisë. Banka e Shqipërisë shpreh mendimin e saj për kriteret e përzgjedhjes së audituesit të jashtëm të fondit jo më vonë se 15 ditë nga marrja e tyre, nëpërmjet administratorit përkatës.

3. Në çdo rast, ASD-ja nuk mund të fillojë procedurat e përzgjedhjes së audituesit të jashtëm përpara përfundimit të afatit të vendosur në pikën 2 të këtij neni.

Neni 18

Shkëmbimi i informacionit

1. ASD-ja raporton çdo tre muaj, pranë Bankës së Shqipërisë mbi veprimtarinë investuese, përbërjen e portofolit të mjeteve financiare dhe gjendjen e “Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme”, si dhe çdo vit, mbi veprimtarinë vjetore të investimit.

2. Banka e Shqipërisë njofton menjëherë ASD-në për përshtatjen ose ndërprerjen e veprimtarisë investuese në rastet e nevojës për likuiditet apo nevojave të tjera urgjente.

KREU VI TË FUNDIT

Neni 19

Sanksionet

1. Banka e Shqipërisë, në rast të shkeljes së dispozitave të kësaj rregulloreje nga bankat, zbaton sanksionet e parashikuara në ligjin “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme”.

2. Për efekt të zbatimit të pikës 1 të nenit 81, të ligjit “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e

jashtëzakonshme”, do të konsiderohet se banka nuk paguan kontribute vjetore në “Fondin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme”, në rast se nuk i ka paguar këto kontribute brenda 45 ditëve kalendarike nga afati i përcaktuar në pikën 3 të nenit 10, të kësaj rregulloreje.

Neni 20

Dispozita kalimtare

1. Banka e Shqipërisë përllorarit dhe njofton bankat për kontributin vjetor të vitit të parë të plotësimit të fondit, brenda datës 15 nëntor 2017.

2. Përlloraritja e nivelit të synuar, nivelit vjetor të “Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme” dhe kontributit vjetor për çdo bankë, për vitin e parë të plotësimit të fondit, bazohen në pasqyrat financiare të vitit 2016.

3. Në përjashtim të pikës 3 të nenit 10 të kësaj rregulloreje, pagesa e kontributit vjetor për vitin e parë të plotësimit të fondit do të kryhet me dy këste si më poshtë:

a) 10% e kontributit vjetor të vitit të parë do të paguhet brenda datës 10 janar 2018;

b) pjesa e mbetur e kontributit vjetor do të paguhet brenda datës 30 prill 2018.

KRYETAR I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Gent Sejko

VENDIM

Nr. 57, datë 3.10.2017

PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK PËR KRYERJEN E VEPRIMTARISË FINANCIARE SHITESË NGA BANKA INTESA SANPAOLO ALBANIA SHA

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja “e”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; nenit 194, pika 4, të ligjit nr. 52/2014, datë 22.5.2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”; nenit 23, pikat 1 dhe 3, të nenit 24, pika 1, shkronja “ç”, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; dhe të nenit 18, pika 8, të rregullores “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 14, datë 11.3.2009, të ndryshuar; me propozim të Departamentit të



Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të japë miratimin paraprak për kryerjen nga Banka Intesa Sanpaolo Albania sh.a. të veprimtarisë financiare shtesë të ndërmjetësimit në sigurime, në cilësinë e agjentit në sigurime.

2. Autorizohet Guvernatori i Bankës së Shqipërisë për të bërë ndryshimet përkatëse në aneksin e licencës së Bankës Intesa Sanpaolo Albania sh.a., pas paraqitjes të licencës së dhënë nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

4. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gent Sejko

VENDIM

Nr. 58, datë 3.10.2017

**PËR DISA NDRYSHIME NË
RREGULLOREN “MBI RAPORTIMET NË
BANKËN E SHQIPËRISË SIPAS
SISTEMIT RAPORTUES TË UNIFIKUAR”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a”, nenit 43, shkronja “c”, nenit 27, nenit 58, nenit 70, pika 1, dhe nenit 71 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 47, pika 4, dhe nenit 126, pika 4, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, neneve 43, pika 3, dhe 62, pika 1, shkronja “c”, dhe nenit 72, pika 5, të ligjit nr. 52/2016, datë 19.05.2016, “Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre”, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Departamentit të Statistikave Financiare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Mbi raportimet në Bankën e Shqipërisë sipas sistemit raportues të unifikuar”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 45, datë 10.6.2009, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Neni 6, pika 1 ndryshon në përmbajtje si më poshtë:

“Ndryshimet në sistemet raportuese mund të propozohen prej njërit nga departamentet e mëposhtme:

- a) Departamenti i Statistikave Financiare;
- b) Departamenti i Mbikëqyrjes;
- c) Departamenti i Politikës Monetare;
- d) Departamenti i Operacioneve Monetare;
- e) Departamenti i Stabilitetit Financiar.

Për çdo ndryshim në sistemet raportuese, departamentet e përcaktuara në shkronjat “b”, “c”, “d” dhe “e” të kësaj pike bashkëpunojnë me Departamentin e Statistikave Financiare.”

b) Në nenin 11, pika 2 ndryshon në përmbajtje si më poshtë:

“2. Raportimi për subjektet financiare jobanka, shoqëritë e kursim-kreditit dhe unioneve të tyre sipas kësaj rregulloreje bëhet në formë shkresore dhe në formë elektronike.”

c) Në nenin 11, pika 2/1 ndryshon në përmbajtje si më poshtë:

“Raportimi nga subjektet banka bëhet në formë elektronike nëpërmjet Sistemit Elektronik Raportues Rregullator - ERRS.”

d) Në nenin 11, pika 3 shfuqizohet.

e) Në nenin 11, pika 5 ndryshon në përmbajtje si më poshtë:

“Çdo fletë e plotësuar e formularit të sistemeve raportuese për subjektet financiare jobanka, shoqëritë e kursimit dhe unionet e tyre duhet të përmbajë gjenealitetet dhe nënshkrimin e specialistit të subjektit përkatës raportues, që përgatit këtë raportim.”

f) Formularët F40, F41, F42, F43 bashkëlidhur kësaj rregulloreje shfuqizohen.

g) Miratohet formulari F49 bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen Departamenti i Statistikave Financiare dhe Departamenti i Mbikëqyrjes, në Bankën e Shqipërisë me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gent Sejko



Formularët që shfuqizohen

NR. I FORMULARIT F40

EMRI I FORMULARIT Aktivet sipas periudhës së riçimitit

NR. I FORMULARIT:	40
EMRI I FORMULARIT:	Aktivt sipas periudhës së riçimitit
PERIODICITETI:	Tremujor
MONEDHA E RAPORTIMIT:	ALL
NJËSIA:	Njësi monetare

Aktivet sipas periudhës së riçimitit*	MUAJ												VITE												TOTALI							
	<1				1-3				3-6				6-12				1-5				> 5					Jo të ndjeshme ndaj normës së interesit**						
Treguesi (në njësi monetare)	ALL	USD	EUR	Të tjera	ALL	USD	EUR	Të tjera	ALL	USD	EUR	Të tjera	ALL	USD	EUR	Të tjera	ALL	USD	EUR	Të tjera	ALL	USD	EUR	Të tjera	ALL	USD	EUR	Të tjera	ALL	USD	EUR	Të tjera
1. Arka dhe Banka Qëndrore																																0.00
2. Bono thesari dhe bono të tjera të përshtatshme për rifinancim me Bankën Qëndrore																															0.00	
3. Llogari rrjedhëse në bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare																															0.00	
4. Depozita në bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare pa afat me afat	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	
5. Huadhënie bankave institucioneve të kreditit dhe institucioneve të tjera financiare																															0.00	
6. Të tjera me bankat, institucione të kreditit dhe institucioneve të tjera financiare																															0.00	
7. Hua dhe paradhënie afatshkurtër afatmesme afatgjatë minus provigjonet për kreditë	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00		
8. Detyrime të klientëve për llogaritë rrjedhëse																															0.00	
9. Bono dhe letra të tjera me vlerë me të ardhura fikse																															0.00	
10. Bono dhe letra të tjera me vlerë me të ardhura të ndryshueshme																															0.00	
11. Interesa pjesëmarrës në banka dhe institucione financiare në të tjera	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00		
12. Mjete të qëndrueshme të patrupëzuara (neto) (minus amortizimin)																															0.00	
13. Mjete të qëndrueshme të trupëzuara (neto) (minus amortizimin)																															0.00	
14. Të tjera aktive																															0.00	
Totali i Aktivit	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00		



NR. I FORMULARIT

F41

EMRI I FORMULARIT Pasivet sipas periudhës së riçimitit

NR. I FORMULARIT:	41
EMRI I FORMULARIT:	Pasivet sipas periudhës së riçimitit
PERIODICITETI:	Tremujor
MONEDHA E RAPORTIMIT:	ALL
NUËSIA:	Njësi monetare

Pasivet sipas periudhës së riçimitit*	MUAJ												VITE												TOTALI				
	<1				1-3				3-6				6-12				1-5				>5					Jo të ndjeshme ndaj normës së interesit**			
Treguesi (në njësi monetare)	ALL	USD	EUR	Të tjera	ALL	USD	EUR	Të tjera	ALL	USD	EUR	Të tjera	ALL	USD	EUR	Të tjera	ALL	USD	EUR	Të tjera	ALL	USD	EUR	Të tjera	ALL	USD	EUR	Të tjera	
1. Banka Qëndrore																													0.00
2. Llogari rrjedhëse nga bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare																													0.00
3. Llogari rrjedhëse në bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare																													0.00
4. Depozita nga bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
pa afat																												0.00	
me afat																												0.00	
5. Hua marrë nga bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare																												0.00	
6. Detyrime ndaj klientëve për llogaritë rrjedhëse dhe depozita depozita																												0.00	
7. Detyrime ndaj Qeverisë Shqiptare dhe administratës publike																												0.00	
8. Detyrime nga bonot dhe letra të tjera me vlerë																												0.00	
9. Ndihma dhe financime publike																												0.00	
10. Fonde rezervë specifike																												0.00	
11. Borxhi i varur																												0.00	
12. Kapitali i aksionerëve																												0.00	
kapitali i paguar																												0.00	
primet																												0.00	
13. Të tjera detyrime																												0.00	
Totali i Pasivit	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	



NR. I FORMULARIT F42

EMRI I FORMULARIT Aktivet jashtë bilancit sipas periudhës së riçimitit

NR. I FORMULARIT:		42																														
EMRI I FORMULARIT:		Aktivet jashtë bilancit sipas periudhës së riçimitit																														
PERIODICITETI:		Tremujor																														
MONEDHA E RAPORTIMIT:		ALL																														
NJËSIA:		Njësi monetare																														
Aktivet jashtë bilancit sipas periudhës së riçimitit*	MUAJ														VITE														TOTALI			
	<1				1-3				3-6				6-12				1-5				>5				Jo të ndjeshme ndaj normës së interesit**							
	ALL	USD	EUR	Të tjera	ALL	USD	EUR	Të tjera	ALL	USD	EUR	Të tjera	ALL	USD	EUR	Të tjera	ALL	USD	EUR	Të tjera	ALL	USD	EUR	Të tjera	ALL	USD	EUR	Të tjera				
Treguesi (në njësi monetare)	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
1. Angazhime financimi të dhëna në favor të bankave dhe institucioneve financiare në favor të klientëve																																
2. Garanci të dhëna në favor të bankave dhe institucioneve financiare në favor të klientëve																																
3. Angazhime për letra me vlerë për t'u marrë																																
4. Letra me vlerë të dhëna si garanci për një kredi ose rifinancim																																
5. Letra me vlerë të marra hua																																
6. Angazhime të tjera																																
7. Angazhime për instrumente financiare të dhëna																																
8. Transaksione valutore valutë e blerë sipas kontratave me afat																																
Totali i zërave jashtë bilancit të aktivit	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00



NR. I FORMULARIT

F43

EMRI I FORMULARIT Pasivet jashtë bilancit sipas periudhës së riçimitit

NR. I FORMULARIT:	43
EMRI I FORMULARIT:	Pasivet jashtë bilancit sipas periudhës së riçimitit
PERIODICITETI:	Tremujor
MONEDHA E RAPORTIMIT:	ALL
NIËSIA:	Njësi monetare

Pasivet jashtë bilancit sipas periudhës së riçimitit*	MUJ												VITE												TOTALI				
	<1				1-3				3-6				6-12				1-5				>5					Jo të ndjeshme ndaj nomës së interesit**			
Treguesi (në njësi monetare)	ALL	USD	EUR	Të tjera	ALL	USD	EUR	Të tjera	ALL	USD	EUR	Të tjera	ALL	USD	EUR	Të tjera	ALL	USD	EUR	Të tjera	ALL	USD	EUR	Të tjera	ALL	USD	EUR	Të tjera	
1. Angazhime financimi të marra	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
nga bankat dhe institucionet e kreditit																													0.00
nga klientët																													0.00
2. Garanci të marra	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
nga bankat dhe institucionet e kreditit																													0.00
nga klientët																													0.00
3. Angazhime për letra me vlerë për t'u dhënë																													0.00
4. Letra me vlerë të marra si garanci për një kredi ose rifinancim																													0.00
5. Letra me vlerë të dhëna hua																													0.00
6. Angazhime të tjera																													0.00
7. Angazhime për instrumente financiare të marra																													0.00
8. Transaksione valutore																													0.00
valutë e shitur sipas kontratave me afat																													0.00
Totali i zërave jashtë bilancit të pasivët	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00

***Formulari i ri*****NR. I FORMULARIT** F49**EMRI I FORMULARIT** Ecuria e portofolit të kredisë sipas klasave

NR. I FORMULARIT	F49									
EMRI I FORMULARIT	Ecuria e portofolit të kredisë sipas klasave									
PERIODICITETI	3 Mujore									
MONEDHA RAPORTUESE	ALL									
NJESIA	Monetare									

Protofoli i kredisë në Lekë	Njësia e raportimit: Lekë
-----------------------------	---------------------------

Protofoli i kredisë	Gjendja në fillim të periudhës	Kreditë e reja	Shlyerjet e kredisë	Kalimet nga klasa standard	Kalimet nga klasa në ndjekje	Kalimet nga klasa nënstandard	Kalimet nga klasa e dyshimtë	Kalimet nga klasa e humbur	Fshirjet e kredisë	Gjendja në fund të periudhës
Standard										-
Në Ndjekje										-
Nënstandard										-
E dyshimtë										-
E humbur										-

Protofoli i kredisë në EUR - brenda vendit	Njësia e raportimit: EUR
--	--------------------------

Protofoli i kredisë	Gjendja në fillim të periudhës	Kreditë e reja	Shlyerjet e kredisë	Kalimet nga klasa standard	Kalimet nga klasa në ndjekje	Kalimet nga klasa nënstandard	Kalimet nga klasa e dyshimtë	Kalimet nga klasa e humbur	Fshirjet e kredisë	Gjendja në fund të periudhës
Standard										-
Në Ndjekje										-
Nënstandard										-
E dyshimtë										-
E humbur										-



Protofoli i kredive në EUR - jashtë vendit - Shqipëria		Njësia e raportimit: EUR								
Protofoli i kredisë	Gjendja në fillim të periudhës	Kreditë e reja	Shlyerjet e kredive	Kalimet nga klasa standard	Kalimet nga klasa në ndjekje	Kalimet nga klasa nënstandard	Kalimet nga klasa e dyshimtë	Kalimet nga klasa e humbur	Fshirjet e kredive	Gjendja në fund të periudhës
Standard										-
Në Ndjekje										-
Nënstandard										-
E dyshimtë										-
E humbur										-

Protofoli i kredive në USD - brenda vendit		Njësia e raportimit: USD								
Protofoli i kredisë	Gjendja në fillim të periudhës	Kreditë e reja	Shlyerjet e kredive	Kalimet nga klasa standard	Kalimet nga klasa në ndjekje	Kalimet nga klasa nënstandard	Kalimet nga klasa e dyshimtë	Kalimet nga klasa e humbur	Fshirjet e kredive	Gjendja në fund të periudhës
Standard										-
Në Ndjekje										-
Nënstandard										-
E dyshimtë										-
E humbur										-

Protofoli i kredive në USD - jashtë vendit		Njësia e raportimit: USD								
Protofoli i kredisë	Gjendja në fillim të periudhës	Kreditë e reja	Shlyerjet e kredive	Kalimet nga klasa standard	Kalimet nga klasa në ndjekje	Kalimet nga klasa nënstandard	Kalimet nga klasa e dyshimtë	Kalimet nga klasa e humbur	Fshirjet e kredive	Gjendja në fund të periudhës
Standard										-
Në Ndjekje										-
Nënstandard										-
E dyshimtë										-
E humbur										-

Protofoli i kredive në monedha të tjera		Njësia e raportimit: Lekë								
Protofoli i kredisë	Gjendja në fillim të periudhës	Kreditë e reja	Shlyerjet e kredive	Kalimet nga klasa standard	Kalimet nga klasa në ndjekje	Kalimet nga klasa nënstandard	Kalimet nga klasa e dyshimtë	Kalimet nga klasa e humbur	Fshirjet e kredive	Gjendja në fund të periudhës
Standard										-
Në Ndjekje										-
Nënstandard										-
E dyshimtë										-
E humbur										-



Protofoli i kredive në total*		Njësia e raportimit: Lekë								
Protofoli i kredisë	Gjendja në fillim të periudhës	Kreditë e reja	Shlyerjet e kredive	Kalimet nga klasa standard	Kalimet nga klasa në ndjekje	Kalimet nga klasa nënstandard	Kalimet nga klasa e dyshimtë	Kalimet nga klasa e humbur	Fshirjet e kredive	Gjendja në fund të periudhës
Standard										
Në Ndjekje										
Nënstandard										
E dyshimtë										
E humbur										

* për këtë portofol formulat në kolonën e fundit nuk janë vendosur për shkak të mospërputhjes që mund të kenë si pasojë e efektit të kursit të këmbimit

Protofoli i kredive në EUR - jashtë vendit - Kosova		Njësia e raportimit: EUR								
Protofoli i kredisë	Gjendja në fillim të periudhës	Kreditë e reja	Shlyerjet e kredive	Kalimet nga klasa standard	Kalimet nga klasa në ndjekje	Kalimet nga klasa nënstandard	Kalimet nga klasa e dyshimtë	Kalimet nga klasa e humbur	Fshirjet e kredive	Gjendja në fund të periudhës
Standard										-
Në Ndjekje										-
Nënstandard										-
E dyshimtë										-
E humbur										-

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa: Rr “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel/fax +355 4 24 27 004 Tel +355 4 24 27 006

Çmimi 140 lekë